

Titulli i lëndës: TEORIA DHE PRAKTIKA E RESTAURIMIT

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Departamenti i Arkitekturës
Titulli i lëndës:	Teoria dhe Praktika e Restaurimit
Niveli:	MScA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+1
Kreditë ECTS:	4
Koha / Vendi:	sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof.Ass.Kaltrina Thaçi Cenaj
Të dhënat kontaktuese:	Kaltrina.thaci@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Lënda është konceptuar që të mundësojë studentët që të njihen për së afërmi me teorinë dhe qasjet e restaurimit dhe të konservimit urban, si dhe me praktikën e konservimit-restaurimit në botë dhe në Kosovë. Komponenta praktike e lëndës përfshin hartimin e projektit të restaurimit që si rezultat do t'u mundësojë studentëve përcaktimin e drejtë të llojit dhe niveit të ndërhyrjes, prezentimit optimal dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të trashëgimisë së ndërtuar në kushte bashkëkohore. Projekti i restaurimit kërkon si parakusht hartimin e dokumentacionit teknik të gjendjes ekzistuese të lokalitetit/monumentit, prandaj, kjo lëndë si prerrekuizit ka kryerjen me sukses të obligimeve të lëndës Mbrojtja e Trashëgimisë Arkitekturale.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i kursit është që studentët të fitojnë njohuritë themelore në leximin e mjedisit kulturor, të aftësohen në valorizim dhe përshkrim të testit të autenticitetit sipas standardeve evropiane dhe praktikave të UNESCOs. Në kuptimin e njësimi teorik me praktikën e restaurimit, kursi synon aftësimin e studentëve në aplikim shkencor dhe të ndjeshëm të parimeve, masave dhe teknikave të restaurimit, të nevojshme për krijimin e kulturës së projektimit arkitektonik për ndërtesa dhe zona historike, në linjë me trendet bashkëkohore dhe nevojat për shfrytëzimin e qëndrueshëm të trashëgimisë së ndërtuar.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none">– zhvillojë ndjeshmërinë për aplikim të parimeve dhe shkallëve të ndërhyrjes gjatë hartimit të projektit të restaurimit– krijojë qasje të bazuar në propozimet e restaurimit

	<p>duke harmonizuar nivelet e lejuara të intervenimit me kërkesat e shfrytëzimit të ndërtesës/lokalitetit</p> <p>– nxisë kreativitetin dhe invencionin në rikrijim të qëndrueshëm arkitektonik nëpërmjet “modestisë” së qasjes minimale por domethënëse dhe konceptuale, si kusht për mbrojtje dhe ruajtje të autenticitetit/integritetit dhe rritjes së vlerës së trashëgimisë kulturore</p>
--	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	1	15	15
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	14	7
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	1	5	5
Detyrë shtëpie	1	10	10
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	10	10
Përgatitja për provimin final	2	7	14
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	5	5
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...			
Total			100

Metodat e mësimdhënies:

Ligjerata tematike, diskutime, punëtori me ligjërues të ftuar, vizita në terren, projekti i restaurimit si detyrë semestrale. Kopja e dokumentacionit të projektit të restaurimit i vëhet në dispozicion Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve të Kosovës.

Metodat e vlerësimit:

(Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 55%. Vijueshmëria e studentit dhe angazhimi aktiv në klasë 10%, Detyrat semestrale dhe prezantimet e studentëve 50%, Vlerësimi nga testet 15% ose Provimi final 40%

Literatura primare:

Jerliu, F. (2022). Mbrojtja e Trashëgimisë Ndërtimore. Historia, konceptet, definicionet, metodat dhe teknikat e mbrojtjes. Botimi 2, Libri Shkollor, Prishtinë

Jerliu, F. (2017). Trashëgimia Kulturore e Kosovës. Konceptet dhe Kontekstet e Mbrojtjes, Prishtinë

Bloszies, C. (2012). Përkth. Jerliu.F. (2021). Ndërtesa të vjetra, dizajne të reja, Cuneus, Prishtinë

Avrami, E., et.al. Eds (2000). Values and Heritage Conservation. Research Report. The Getty Conservation Institute, Los Angeles

	Pickard, R. (2002). European cultural heritage (Volume II) A review of policies and practice, Council of Europe.
Literatura shtesë:	Jerliu, F./MKRS (2017). Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017-2027 Bandarin, F, Oers, R. van (2012). The Historic Urban Landscape. Managing Heritage in an Urban Century, First Edition. Wiley & Blackwell, UK ICOMOS (2004). International Charters. Conservation and Restoration, 2nd edition

Hartimi i planit mësimor		
Java	Titulli i ligjëratës	Ushtrimet
Java 1:	Hyrje në lëndë	Ndarja e grupeve/detyrave
Java 2:	Roli i arkitektit në fushën e trashëgimisë arkitekturale	Diskutim: Trashëgimia-Kujtesa-Identiteti
Java 3:	Vlerësimi i trashëgimisë – valorizimi	Restaurimi i monumentit
Java 4:	Vlera socio-kulturore	Shqyrtim: gjendja ekzistuese
Java 5:	Vlera Ekonomike	Shqyrtim: patologjia
Java 6:	Kriteret e UNESCO: autenticiteti	Shqyrtim: masat teknike
Java 7:	Kriteret e UNESCO: integriteti	Definimi i vlerave të TA
Java 8:	Sistemi i mbrojtjes së TK në Kosovë	Deklarata e sinjifikancës
Java 9:	Politikat dhe Mbrojtja ligjore në Kosovë	Testi i autenticitetit/integritetit
Java 10:	Praktika e konservimit-restaurimit preventiv në Kosovë I	Harmonizimi i Vlerësimit dhe Intervenimit teknik
Java 11:	Praktika e konservimit-restaurimit preventiv në Kosovë II	Përcaktimi i qëllimit të restaurimit dhe "shkollës" së intervenimit
Java 12:	Shkollat e restaurimit	Konsultime: projekti i restaurimit - intervenimi emergjent
Java 13:	Praktikat dhe përvojat e studimeve të trashëgimisë kulturore në Kosovë	Konsultime: projekti i restaurimit
Java 14:	Praktika ndërkombëtare e restaurimit I	Konsultime: projekti i restaurimit
Java 15:	Praktika ndërkombëtare e restaurimit II	Dorëzim i Detyrës

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes
Ligjëratat dhe vizitat studimore janë obligative; ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë; inkurajohet shfrytëzimi i teknologjisë së mençur për dokumentimin e monumentit/lokalitetit, ndërsa nuk lejohen përdorimi i tyre për aktivitete tjera si kontrollimi i e-mailit personal apo rrjeteve sociale.

Shënim | Nëse detyra seminarike e një studenti vlerësohet nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Prerekuizit i kësaj lënde është kryerja e obligimeve semestrale në lëndën "Mbrojtja e Trashëgimisë Arkitekturale".